

VENDIM
Nr.275, datë 26.4.2010

PËR RISTRUKTURIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR
“ALBPETROL” SHA, PATOS, “UZINA MEKANIKE E NAFTËS, KUÇOVË” SHPK DHE
“UZINA MEKANIKE, PATOS” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 215, pika 1, e 216 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin me “Albpetrol” sh.a., Patos, me anë të përthithjes të “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k., dhe të “Uzina Mekanike e Naftës, Kuçovë” sh.p.k.
2. Të gjithë punonjësit aktualë të shoqërive “Albpetrol” sh.a., “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k., dhe “Uzina Mekanike e Naftës, Kuçovë” sh.p.k., që dalin të papunë si pasojë e rristurimit dhe që kanë qenë të punësuar në këto shoqëri për një periudhë 1 (një) – vjeçare, pa ndërprerje, përfitojnë nga ky vendim nga data e hyrjes në fuqi të tij. Këta punonjës përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë me pagë bruto mesatare, mujore, individuale të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe, punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia në zyrat e punësimit.
3. Periudha, gjatë së cilës këta punonjës do të përfitojnë pagesën e përcaktuar në këtë vendim, njihet si periudhë siguri, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror nga “Albpetrol” sh.a., dhe për këtë periudhë bëhet shënimi përkatës për pagesën në librezën e punës.
4. Fondi i nevojshëm, prej 600,5 (gjashtëqind presje pesë) milionë lekësh, për kryerjen e pagesave të punonjësve, që dalin të papunë nga rristurimi i këtyre shoqërive, të përballohet nga likuiditetet e “Albpetrol”, sh.a., e cila do t’i kryejë këto pagesa çdo muaj.
5. Pagesa sipas këtij vendimi ndërpritet kur përfituesit zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit.
6. “Albpetrol” sh.a., do t’i shtohen nga “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k. dhe “Uzina mekanike e naftës, Kuçovë”, sh.p.k., të gjitha asetet për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë sipas inventarëve, të cilat duhet të paraqiten në bilancet e tyre.
7. Sistemin e detyrimeve të ndërsjella, debitoare dhe kreditore, të shoqërive të sipërpërmendura dhe pasqyrimin në bilancin e “Albpetrol” sh.a., të diferencave të rezultuara.
8. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha